

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Goditja e radhës për Erion Veliajn/ Gjykata e Lartë e lë në burg
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/gjykata-e-larte-i-jep-goditjen-e-radhes-veliajt-e-le-ne-burg-i474200
BURIMI	cna.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 09:14:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 09:07:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5b3c705eba7a3cd839e26f9936fbd5061e35340c4eeae9fa273793f26078a41e
TEKSTI	5305d876a0583098f9b20b81dd2095088381d84bd107f5b7d8197087d91bfcdb
PAMJA	4841cb2736f0195f007d7f1f14e0bcba78192549f4d9d68775635b3d361286a9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0df4b0fc293075571debd88da997a79efc365712c0912a6742e2748808175144
E MËPARSHMJA	38649cd6d4494ccdbda20093ecbe545b90b48f42dfaf4f4041a2e449eaf7326d
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0df4b0fc293075571debd88da997a79efc365712c0912a6742e2748808175144>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)




English
English

Goditja e radhës për Erion Veliajn/ Gjykata e Lartë e lë në burg



15 Shtator 2026, 11:07, Aktualitet CNA



Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi masën e sigurisë "arrest në burg" për kryebashkiakun e Tiranës, Erion Veliajn.

Më konkretisht, në seancën e sotme gjyqësore është lënë në fuqi vendimi i datës 13 mars 2025 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Veliaj kishte bërë kërkesë për rekurs të masës së sigurisë me arsyetimin se ai është i njohur si kryetar bashkie nga Gjykata Kushtetuese dhe duhet të kthehet në detyrë.

Vendimi i plotë:

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i mbledhur në datë 15 shtator 2026, në Dhomë Këshillimi, mori në shqyrtim dosjen penale me palë:

Kërkues: Erion Veliaj,

Palë e Interesuar: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe objekt: Shfuqizimin e vendimeve nr. 7, dt. 09.02.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vlefësuar përmes vendimit nr. 14, dt. 12.02.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 13, dt. 13.03.2025, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1153 (176), dt. 08.07.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të subjektit të interesuar.


Pasi shqyrtoi çështjen, Kolegji, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja "e" të Kodit të Procedurës Penale, vendosi:


Lënen në fuqi të Vendimit nr.13 (87-2025-85), datë 13.03.2025 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjyqi i ditës së sotme cilësohej edhe si një betejë e drejtësisë me korrupsionin. Kjo për faktin se kryetari i Bashkisë së Tiranës me 13 akuza të rënda penale, Erion Veliaj, ndodhet në qelitë e burgut të Durrësit dhe me të gjitha vendimet në të gjitha shkallët e gjykatave masa e tij e sigurisë është quajtur e ligjshme.

Nga ana tjetër, prej 14 muajsh Erion Veliaj nuk pranon që të gjykohet, pra nuk shkon në gjykatë.

Për më tepër në këta 14 muaj pas dorëzimit të dosjes së tij në GJKKO ai ka vazhduar betejën e tij me drejtësinë duke sulmuar prokurorë e gjyqtarë që nga ndalimi i tij në shkurt të vitit 2025. /CNA





Të sugjeruara

Rritja e çmimit të naftës/ Bozdo: Situata emergjente, qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale

Audio-përgjimi për Ron Yeffet/ Kalaja: Rama ka dalë zbuluar me korrupsionin e tij

Seanca për Veliajn/ Protestë para Gjykatës së Lartë

Emërohet Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së

Dosja “Revanshi”/ GJKKO shpall vendimin për Durim Bamin dhe 6 të tjerë

“O gjyqtar bëj drejtësi, lër Veliajn në qeli”/ Thirrja e protestuesve para Gjykatës së Lartë

Erion Veliaj kërkon të kthehet në vendin e krimit/ Sot, seanca në Gjykatën e Lartë

Projekti për bujqësinë/ BB: Mund të ristrukturohet ose të anulohen fonde

Protesta para shkollës/ Hoxha: Goditja ndaj protestuesit ishte për ta përkulur

“Rama dhunoi pasagjerin”/ Berisha: Kreu i organizatës çan me thonj qytetarin

“Nëse e keni harruar, kujtohuni nesër”/ Gjokutaj, mesazh gjykatave për afatet e paraburgimit

Audio-përgjimi/ Këllici: Roni i Ramës paska të gjithë qeverinë në dorë

Gazetari: 30 milionë euro të taksapaguesve janë dhënë për makina që saldohen në një kapanon

“Mbështetuni te unë për Ministrinë e Energjetikës”/ Zbardhet një tjetër pjesë e audio-përgjimit për Ron Yeffet

Protestuesit para komisaritit numër 3: Lironi trimat, arrestoni Ramën

“Korrupsioni e dobëson shtetin”/ Mesazhet e protestuesve përmes pankartave

Gazetari: SPAK t'i hapë një çështje Sadushit, këtë ku ta kapësh të ngel në dorë

Nesër seanca në Gjykatën e Lartë/ Bardhi: Nëse Veliaj del nga burgu, ky do jetë funerali i Reformës në Drejtësi

Dhuna ndaj protestuesit/ Balla: Policia bëri detyrën, perimetri i sigurisë, i paprekshëm


A do të shtyhet gjyqi i Veliajt nesër në Gjykatën e Lartë?

[editorial](#)

16:28 Editorial Elvi FUNDO

Edhe një herë për deputetin analfabet dhe “mbështetësit” e tij

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

20:44 Opinione Albert Vataj

Ekspertët zbulojnë shtatë sjellje të çuditshme që mund të lidhen me inteligjencën e lartë

17:57 Opinione Sherafedin Shahri

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.